



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:182916

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05644437

PPP. Nr. 820/22

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Ilire Vitija, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit R.. B.. K.. Sh. A., me numër unik identifikues 8., me seli në P., kundër debitorit M.. B., me vendbanim në R.. Sh.. i A.. p.n., 10.. P., për pagesën e borxhit, në vlerë prej EUR 918.66 (nëntëqind e tetëmbëdhjetë Euro e gjashtëdhjetë e gjashtë cent), duke vendosur sipas prapësimit të debitorit kundër Urdhrit për Përmbarim P. Nr. 304/22, i datës 18.07.2021, i Përmbarueses Private S.. R., jashtë seancës, me datën 25.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET** në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit M.. B.. nga P., dhe **ANULOHET** në tërësi Urdhri Përmbarimor P. Nr. 304/2022, i datës 18.07.2021, i Përmbarueses Private S.. R...

Arsyetimi

Kreditori me datën 13.07.2022 ka paraqitur pranë Përmbarueses Private S.. R.. propozim për përmbarimin e borxhit në shumën prej EUR 918.66 (nëntëqind e tetëmbëdhjetë Euro e gjashtëdhjetë e gjashtë cent), kamatës së rregullt dhe kamatëvonesës. Sipas propozimit për përmbarim, kreditori ka theksuar se me debitorin, me datën 25.03.2014, kanë nënshkruar Marrëveshjen mbi lëshimin dhe shfrytëzimin e Visa Plus/Gold kredit kartelës dhe po të njëjtën datë kanë nënshkruar edhe Shtojcën 1 të marrëveshjes së tillë, sipas së cilës debitorët kanë lënë

peng pasuri të paluajtshme si garanci për përmbushjen e marrëveshjes së lartpërmendur. Po ashtu, ka shtuar se e drejta e pengut është regjistruar në Sektorin për Regjistrimin e Pengut të Luajtshëm pranë Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, për çka si dëshmi ka bashkangjitur Konfirmimin/Certifikatën e Regjistrimit të Pengut të Luajtshëm R-20., të datës 08.07.2022. Të gjitha dokumentet e bashkangjitur me propozimin për përmbarim, ashtu siç janë pranuar në Gjykatë nga Përmbaruesja Privat S.. R., janë dorëzuar nga kreditori në kopje të pa vërtetuara dhe/apo të noterizuara.

Kreditori në propozim për përmbarim ka theksuar se debitori ka mbetur borxh për shumën prej EUR 918.66 (nëntëqind e tetëmbëdhjetë Euro e gjashtëdhjetë e gjashtë cent), andaj ka propozuar që të caktohet përmbarimi i propozuar dhe të bllokohen të gjitha llogaritë e debitorit nëpër të gjitha Bankat komerciale dhe të barten mjetet monetare në shumën e borxhit me qëllim të përmbushjes së borxhit të debitorit, karshi kreditorit.

Me datën 18.07.2021 (data duhet të jetë 18.07.2022, pasi që data e pranimit të propozimit për përmbarim është 13.07.2022, si dhe lënda mban numrin P. Nr. 304/2022), Përmbaruesja Private S.. R.. e ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor P. Nr. 304/2022, me të cilin e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga kreditori.

Me datën 09.08.2022, debitori ka paraqitur prapësim duke propozuar që të aprovohet prapësimi, hedhet si i pabazuar Urdhri Përmbarimor P. Nr. 304/2022, i datës 18.07.2021, i Përmbarueses Private S.. R., pasi që – sipas debitorit – borxhi i kërkuar nuk qëndron pasi e njëjta e ka përmbushur në tërësi borxhin nga kredit kartela dhe se ka paguar çdo muaj këste në vlerë nga EUR 50.00 (pesëdhjetë Euro) e shumë herë nga EUR 100.00 (një qind Euro) nga viti 2014 deri në vitin 2018. Sipas prapësimit të debitorit, për katër vite ka paguar jo EUR 1,000.00 (një mijë Euro), por afër EUR 5,000.00 (pesë mijë Euro). Po ashtu, debitori ka theksuar se certifikata e regjistrimit të pengut si dhe marrëveshja e pengut, ka të bëjë me pengun e një kredie tjetër të cilën e ka paguar me kohë dhe se pengun i prezantuar nga kreditori nuk ka të bëjë me kartelën Visa Plus/Gold, pasi që për të njëjtën nuk ka lënë peng e as që i është kërkuar kurrfarë peng. Ka shtuar se llogaria kredit kartela ka pasur afat/ka qenë valide deri në mars 2018 dhe se nuk ka asnjë borxh të pa paguar nga kredit kartela e tillë.

Me datën 10.08.2022 kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, në të cilën ka kërkuar që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të lihet në fuqi urdhri përmbarimor. Sipas përgjigjes së

kreditorit në prapësimin e debitorit, prapësimi nuk është mbështetur me asnjë provë dhe si i tillë është i pabazuar dhe i pambështetur me asnjë provë siç kërkohet me dispozitat përkatëse ligjore. Ka theksuar se pretendimet për mos ekzistimin e borxhit janë të pa bazuara pasi që në momentin e nënshkrimit të kontratës së kredisë palët i kanë pasur të njohura detyrimet e tyre dhe se paraqitja e prapësimit ka për qëllim të tejzgjatjes së procedurës për të mos e përmbushur detyrimin. Ka shtuar se propozimi përmbarim është bazuar në një dokument përmbarimor, e cila njihet sipas dispozitave ligjore si dokument përmbarimor, si dhe certifikata e regjistrimit të pengut sipas dispozitave të aplikueshme ligjore konsiderohet si dëshmi edhe kur lëshohet në formë elektronike dhe se sipas dispozitave të procedurës nuk ka nevojë të provohen faktet që presupozohen nga ligji por mund të vërtetohet mos-ekzistimi i tyre. Andaj, i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të lihet në fuqi Urdhri Përmbarimor P. Nr. 301/2022, i datës 18.01.2021, i lëshuar nga Përmbaruesja Private S.. R...

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të pasqyruara në prapësimin e paraqitur, propozimit për përmbarim, përgjigjes së kreditorit në prapësimin e debitorit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka ardhur në përfundim se prapësimi i debitorit është **i bazuar**.

Gjykata vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi për arsyet si në vijim. Sipas Nenit 21 Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 3, të datës 31 janar 2013 (“**Ligji për Procedurën Përmbarimore**” apo “**LPP**”), përcaktohet se “[o]rgani [p]ërmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit të besueshëm (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.” Ndërsa, sipas Nenit 22, paragrafi 1, pika 1.7a, të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, përkatësisht Nenit 5, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (këtu e tutje referuar se si (“**Ligji për Plotësimin e LPP**”) – ndër tjera – si dokument përmbarues përcaktohet edhe “kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut.”

Në rastin konkret, kreditori e ka propozuar dhe Përmbaruesja Private S.. R.. e ka caktuar përmbarimin duke u bazuar në dokumentin e titulluar “Shtojca: 1) Marrëveshja mbi Pengun (kolaterali i lënë peng nga Shfrytëzuesi),” duke e cilësuar si kontratë të pengut të njëjtin dokument, rrjedhimisht duke e cilësuar (së bashku me Konfirmimin/Certifikatën e Regjistrimit të Pengut të Luajtshëm R-20220708-546, të datës 08.07.2022) si dokument përmbarimor/titull ekzekutiv (titulus executionis).

Në lidhje me këtë, gjykata vlerëson se dokumenti i tillë nuk i titulluar “Shtojca: 1) Marrëveshja mbi Pengun (kolaterali i lënë peng nga Shfrytëzuesi),” nuk i përmban tiparet dhe elementet thelbësore të një kontrate, për tu vlerësuar dhe cilësuar si kontratë e vlefshme dhe detyruese ndërmjet palëve. Kjo pasi në rastin konkret kemi të bëjmë me një detyrim që rrjedh nga një kontratë e kredisë, specifikisht kontratë mbi shfrytëzimin e mjeteve të kreditorit nga debitori nëpërmjet mjetit elektronik të pagesës së quajtur Visa Plus/Gold (kredit kartelë). Sipas Kreut XXXV të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë Nr. 29/1978, e datës 26.05.1978 (këtu e tutje referuar si “**Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i RSFJ-së**”), i aplikueshëm në rastin konkret, në rastin e kontratës së kredisë nuk krijohet pengu ligjor i kredidhënësit, këtu kreditorit, siç është rasti me disa lloje të kontratave tjera. Rrjedhimisht, derisa nuk kemi peng ligjor, kemi të bëjmë me peng jo-posedimor të krijuar sipas kontratës. Prandaj, për të vlerësuar nëse pengu kontraktual – si bazë ligjore në procedurë përbarimore – është i vlefshëm, duhet vlerësuar nëse kontrata që e ka krijuar pengun e tillë është e vlefshme.

Në rastin konkret, dokumenti i referuar si kontratë pengu dhe i titulluar “Shtojca: 1) Marrëveshja mbi Pengun (kolaterali i lënë peng nga Shfrytëzuesi),” nuk përmban elementet esenciale të një kontrate të vlefshme. Ndër elementet esenciale të një kontrate janë, palët e kontratës, detyrimi i kontraktuar, afati i përmbushjes, kushtet e përmbushjes, etj. Në rastin konkret dokumenti të cilit kreditori i referohet si kontratë e pengut nuk i përmban/identifikon palët (përveç se në fund të dokumentet dhe atë jo në cilësi të pengdhënësi dhe pengmarrësit), e as nuk sqaron qartazi se garancia e krijuar sipas kësaj kontrate, se çfarë detyrim e garanton (për çfarë detyrim është lënë pengu i luajtshëm). Rrjedhimisht, Gjykata vlerësoi si dokumenti i titulluar “Shtojca: 1) Marrëveshja mbi Pengun (kolaterali i lënë peng nga Shfrytëzuesi),” nuk i plotëson elementet esenciale të një kontrate të vlefshme juridikisht, andaj edhe e njëjta nuk mund të shërbej si dokument përbarimor në procedurë përbarimore. Pra, edhe pse Gjykata pajtohet me interpretimin e kreditorit se kontrata e pengut për nga qëllimi është kontratë aksesore që shërben për sigurimin një detyrimi, në aspektin formal juridik, kontrata e pengut paraqet kontratë në vetë dhe si e tillë duhet t’i përmbajë elementet e një kontrate, që në rastin konkret dokumenti i titulluar “Shtojca: 1) Marrëveshja mbi Pengun (kolaterali i lënë peng nga Shfrytëzuesi),” nuk i përmban elementet e tilla.

Në lidhje me këtë, duhet theksuar se neni 27, paragrafi 1, i Ligjit për Procedurën Përmbartimore shprehimisht përcakton se “Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbartjes së detyrimit.” Rrjedhimisht, nga se u tha më lartë, gjykata erdhi në përfundim se dokumenti mbi bazën e të cilit është kërkuar që të bëhet përmbartimi, nuk është i përshtatshëm për përmbartim.

Për më tepër me Nenin 162, paragrafi 1, pika nga 1.1. deri në 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 57, të datës 4 gusht 2009 (“LPDTS”) parashihet se çfarë duhet të përmbajë regjistrimi i pengut pa posedim në mënyrë që pengu të jetë i vlefshëm dhe të prodhojë efekt juridik. Ndër tjera, regjistrimi i pengut sipas dispozitës së lartpërmendur duhet të përmbajë edhe “përcaktimin e veçantë apo të përgjithshëm të natyrës së detyrimit të siguruar,” dhe “vlerën maksimale të detyrimit të siguruar të shprehur në para.” Ndërsa, në rastin konkret, Konfirmimi/Certifikata e Regjistrimit të Pengut të Luajtshëm R-20.. nuk përmban një përshkrim të tillë. Tek pjesa përgjithshme me numër reference vetëm është shkruar “Kredit Kartele.” Një përshkrim i tillë nuk i përgjigjet kërkesës së Nenit 162, paragrafi 1, pika 1.2. dhe 1.3 të LPDTS dhe nuk përmban përshkrim të detyrimit që sigurohet. Duke pasur parasysh se kreditorit thekson se debitori i ka lënë peng mjetet në llogaritë Bankare të hapura në Bankat tjera (jo pranë kreditorit), i bie që bëhet fjalë për peng jo-posedimor (peng pa posedim). Pengu i tillë për të qenë i vlefshëm duhet të plotësohen kushtet nga Neni 162 i LPDTS. Prandaj, përderisa Gjykata ka vlerësuar se pengu i tillë nuk i plotëson kushtet e tilla Gjykata vlerëson se pengu dhe kontrata e pengut nuk është e vlefshme edhe për shkak se certifikata e regjistrimit të pengut nuk përmban elementet e detyrueshme ligjore për krijimin e një pengut të vlefshëm, siç është arsyetuar më lartë.

Gjykata pajtohet me interpretimin e kreditorit në lidhje me vlefshmërinë e kopjes elektronike të certifikatës së regjistrimit të pengut si dëshmi e mjaftueshme për vërtetimin e faktit se pengu është regjistruar, në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-136 për Regjistrimin e Pengut në Regjistër për Sendet e Luajtshme, të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 33, të datës 23 nëntor 2012. Megjithatë, vlefshmëria e kopjes elektronike të certifikatës së tillë, nuk nënkupton se e njëjta është e vlefshme pavarësisht përmbajtjes së certifikatës së tillë. Pra, fakti se kopja elektronik e certifikatës së pengut të luajtshëm është e vlefshme kur lëshohet në kopje elektronike, nuk nënkupton se e njëjta është e vlefshme edhe nëse nuk i përmban elementet e detyrueshme ligjore, siç është shpjeguar më lartë.

Gjykata gjithashtu vëren se Marrëveshjen mbi lëshimin dhe shfrytëzimin e Visa Plus/Gold, si dhe kartela Bankare e lëshuar mbi bazë të marrëveshjes së tillë, ka qenë me afat shfrytëzimi nga 2014 deri më 2018, siç ka theksuar debitori në prapësim. Ndërsa, nga Konfirmimi/Certifikata e Regjistrimit të Pengut të Luajtshëm R-20..., shihet se pengu është regjistruar me datën 08.07.2022, në ora 14:19 me afat të vlefshmërisë deri më 08.07.2024. Rrjedhimisht, ka një distancë kohore prej tetë (8) vitesh nga kur ka lindur detyrimi dhe kur është regjistruar pengu i luajtshëm. Po ashtu, duke pasur parasysh se nga Konfirmimi/Certifikata e Regjistrimit të Pengut të Luajtshëm R-20220708-546, nuk mund të konstatohet se për cilin obligim bëhet fjalë (pasi nuk është specifikuar detyrimi i siguruar) si dhe duke pasur parasysh se debitori pretendon se për detyrimet e veta nga Marrëveshja mbi lëshimin dhe shfrytëzimin e Visa Plus/Gold nuk ka lënë kurrfarë pengu, Gjykata e vlerëson se nuk mund të vërtetohet fakti se Konfirmimi/Certifikata e Regjistrimit të Pengut të Luajtshëm R-20..., i referohet detyrimeve nga Marrëveshja mbi lëshimin dhe shfrytëzimin e Visa Plus/Gold.

Në lidhje me këtë Gjykata thekson se me aprovimin e prapësimit të debitorit nuk paragjykohet detyrimi eventual që debitori mund të ketë ndaj kreditorit e që rrjedh nga Marrëveshja mbi lëshimin dhe shfrytëzimin e Visa Plus/Gold, e datës 25.03.2014, dhe se Gjykata vetëm ka vlerësuar se sigurimi i detyrimeve të tilla me peng të luajtshëm, nuk i plotëson kushtet ligjore për tu konsideruar i vlefshëm e rrjedhimisht edhe për tu lejuar përmbarimi mbi bazën e tillë.

Gjykata gjithashtu gjeti se dokumenti i titulluar “Shtojca: 1) Marrëveshja mbi Pengun (kolaterali i lënë peng nga Shfrytëzuesi),” në bazë të të cilit kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim është bashkangjitur në kopje të pa vërtetuar/noterizuar, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar tek organi kompetent, e rrjedhimisht propozimi për përmbarim është paraqitur në kundërshtim me Neni 38, paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, i cili përcakton se “[p]ropozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar.” Përkundër kësaj, Përmbaruesja Private si organ përmbarues në këtë çështje përmbarimore nuk ka evituar këto të meta në propozimin për përmbarim, siç kërkohet nga Neni 38, paragrafi 2 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet Nenit 43, paragrafi 4 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore i cili përcakton se “[n]ë lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin

për përmbarrim nga përmbarruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim.” Mbi bazën e tillë ligjore Gjykata gjeti se Urdhri Përmbarrimor P. Nr. 304/2022 i datës 18.07.2021 është nxjerrë pa plotësimin e kushteve për lejimin e përmbarrimit, pasi që propozimi për përmbarrim bazohet në një dokument që nuk është paraqitur në kopje të noterizuar/vërtetuar.

Prandaj, duke u bazuar në arsyetimin e dhënë më lart, si dhe duke u bazuar në Nenin 43, paragrafi 4, Nenin 69, Nenin 71, paragrafi 1, pika 1,1 dhe Nenin 73 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

PPP. Nr. 820/22; datë 25.04.2024

Gjyqtarja,

Ilire Vitija

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.